




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencija za Upravljanje
Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated
Assets

Vendi: Prishtinë

Data: 20.03.2025

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar/periudha;
Janar- Dhjetor/ 2024, paraqet këtë:

RAPORTI VJETOR I PËRFORMANCËS

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ministria e Drejtësisë, në kuadër të angazhimeve të saja për përmbushjen e aktiviteteve në zbatimin e Ligjit; Nr. 03/L-141, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar me Ligjin; (Nr.05/L-049), në korrik të vitit 2010, ka themeluar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e cila është; Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, mbanë përgjegjësi për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruara dhe të konfiskuara, që janë besuar në përkujdesje nga Gjykatat dhe organet tjera. Agjencia kryen funksionet e sajë, me qëllim që të ofrojë administrim të leverdishëm dhe profesional të pasurisë dhe zhvillon punët e saj me integritet dhe transparencë.

Objektivi kryesor i Agjencisë është që të administroj në mënyrë profesionale pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, në mënyrë që të bëhet qendër e shkëlqyeshme në administrimin e pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

2. Hyrje

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë, rrjedhin nga Ligji Nr.05/L-049, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin; Nr.08/L-034, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Agjencia ka një staf prej 26 (njëzetegjashtë) Nëpunës Civil, të ndarë në dy Drejtorate;

1. Drejtorati për Pranim, Vlerësim, Ruajtje të Vlerës dhe Shitje të Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
2. Drejtorati për Punë Normative Juridike dhe Administratë.

Agjencia, aktualisht ka të planifikuara dhe buxhetuara 26 (njëzetegjashtë) pozita të nëpunësve civile, nga të cilat 21 (njëzet e një) pozita aktualisht janë të plotësuara.

Agjencia ka të planifikuar; **391,843.00** buxhet për vitin 2024.

Përgjegjësitë të cilat i përfshinë Agjencia janë; Pranimi, Vlerësimi, Ruajtja, Shitja e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, gjithashtu përgjegjësi është dhënia e llogarisë për fondet e realizuara nga Sekuestrimi dhe Konfiskimi i parave, për paratë e siguruara nga qiratë e pasurive dhe nga shitja e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Agjencia i mban të dhënat që kanë të bëjnë me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe i raporton ato sipas kërkesës si dhe sipas dhe afateve ligjore.

Planin e punës për vitin 2024, Agjencia e ka realizuar në masë të konsiderueshme me të gjitha aktivitetet e përcaktuara për objektivat. Vlen të theksohet, se janë ndërmarrë veprime adekuate lidhur me vendimet e dërguara nga Gjykatat e Republikës së Kosovës për Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë, ku në këtë drejtim, janë ekzekutuar 233 (dyqind e tridhjetë e tre) vendime të dërguara nga Gjykatat e Republikës së Kosovës, prej tyre 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) për Sekuestrim dhe 107 (njëqind e shtatë) për Konfiskim, 30 për kthimin e pasurive. Sipas vendimeve të lartë përmendura, për vitin 2024, vlera e përafërt është rreth; 5,868,665.75 €.

Janë dhënë në shfrytëzim pesëdhjetë e gjashtë (56) mjete të transportit, dy (2) banesa, një (1) autoambulancë dhe pajisje të ndryshme elektronike në vlerë të përafërt prej 500,000.00€

Gjatë vitit 2024 janë kthyer pasuri me vlerë të përafërt prej 844,943.39 nga të cilat 157,273.39 mjete monetare.

Agjencia gjatë kësaj periudhe, ka hartuar treqind e tete (308) raporte të vlerësimit të Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar,

Janë zhvilluar gjithsej: 16 (gjashtëmbëdhjetë) procedura të shitjes përmes Ankandit Publik, ku mjetet e realizuara nga zhvillimi i procedurave të shitjes për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, për periudhën raportuese janë; 52.051.10 €

Po ashtu, janë dhënë në shfrytëzim tek Institucionet përkatëse, vetura dhe sende të tjera, siç janë përcaktuar me vendime të AAPSK-së dhe Gjykatës.

Në përputhje me mandatin e sajë dhe dispozitat Ligjore, Agjencia ka administruar të hyrat nga sekuestrimet dhe konfiskimet, të cilat do të shpalosim si në vijim:

3. Përmbledhje e të dhënave nga fushëveprimi i AAPSK-së

Aktiviteti i Divizionit për Buxhet dhe Financa;

Tabela e përshkrimit të aktiviteteve të DBF

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Nr. i kërkesave të pranuar	Nr. i zotimeve-transaksioneve të kryera	Gjithsejtë
1	Kërkesat e pranuar për zotim	183	183	183
2	Kërkesat e pranuar për shpenzim	536	536	536
3	Kërkesat e pranuar për certifikim(aprovim)	536	536	536

Raporti i të hyrave të konfiskuara dhe depozitave të sekuestruara janar-dhjetor 2024 me bartjen e depozitave të sekuestruara nga viti 2023

Nr.	Përshkrimi i të hyrës-depozitës	Kodi	Bartja e depozitave 2023 me SIMFK	Realizimi i të hyrës-depozitës janar-dhjetor 2024	Transf. i depoz. në konfisk.(buxhet) 2024	Kthimi i depozitave 2024	Totali i përgjithshëm 2024
1	Depozitat nga Sekuestrimet	83011	4,088,842.01	482,324.72		- 174,560.38	4,396,606.35
2	Të hyrat nga Konfiskimet	50111	123,092.07		-123,092.07		
	Totali		4,211,934.08	482,324.72	-123,092.07	- 174,560.38	4,396,606.35

Buxheti i realizuar për periudhën janar-Dhjetor 2024 – AAPSK (215-371)

Nr.	Kategoria ekonomike	Buxheti përfundimtar SIMFK vitin 2024	Alokimet e buxhetit për janar-Dhjetor 2024	Realizimi i buxhetit - shpenzimet janar-Dhjetor 2024	Përqind. Reali. me Buxhet (%)
1	Paga dhe mëditje	222,663.00	180,222.26	180,222.26	80.94%
2	Mallra dhe shërbime	154,180.00	154,180.00	127,915.66	82.97%
3	Shpenzime komunale	15,000.00	15,000.00	4,585.89	30.57%
4	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	00.00	0.00%
	Total buxheti	391,843.00	349,402.26	312,723.81	79.81%

Shpalosja e shënimeve; Periudha Janar-Dhjetor 2024 - Buxheti në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime është realizue për 82.97%, sepse pjesa më e madhe e Buxhetit për vitin 2024 ka

qenë e shpërndarë në: shpenzimet për shërbime kontraktuese dhe për shpenzimet për sigurimin e ndërtesave.

Vendimet e Ekzekutuara 2024

<i>Vendimi për 2024</i>	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
SEKUESTRIM	9	8	10	4	1	15	14	3	5	11	12	4	96
KONFISKIM	5	14	17	3	3	13	2	7	11	18	6	8	107
TOTAL	14	22	27	7	4	28	16	10	16	29	18	12	203
<i>Nr. i Dosjeve</i>	1-14	15-36	37-63	64-70	71-74	75-102	103-118	119-128	129-144	145-173	174-191	192-203	

Tabela e pasurive të pranura sipas kategorive (llojit) për periudhën Janar-Dhjetor 2024

<i>Llojet e Pranimi të Pasurive</i>	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
Mjete Transporti	9	60	24	6	0	24	10	1	10	23	24	13	204
Pajisje elektronike	4	2	2	0	0	3	0	5	6	2	1	1	26
Para të gatshme	4	1	8	5	4	5	7	6	5	11	2	2	60
Palujtshmëri	0	0	0	5	0	0	0	0	0	0	5	0	10
Të ndryshme	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1

Vlerësim:

Ne tabelën e mëposhtme do paraqesim vlerat e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për periudhën janar- dhjetore 2024:

Nr.	Statusi	Nr. i vendimeve	Vlera/€
1	Sekuestrim	96	€ 4,612,034.41
2	Konfiskim	107	€ 1,256,631.34
3	Total:	203	€ 5,868,665.75

Gjate kësaj periudhe vlen të ceket se janë punuar 308 raporte të vlerësimit për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Grafika e vlerave të pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara sipas përqindjes % për periudhën një vjeçare 2024:



Ruajtja e Vlerës:

Gjate periudhës janar-dhjetor, Kemi bërë vizita te rregullta te pasuritë e paluajjtshme me qellim te administrimit dhe ruajtjes se vlerës se tyre për te cilat kemi raportuar ne baza ditore dhe javore, vlen të ceket qe nuk kemi pas ndonjë dëmtim apo humbje te vlerës përveç amortizim ne kohe.

Divizionit te Shitjes se pasurisë se sekuestruar ose konfiskuar

Divizionin i shitjes se pasurisë se sekuestruar ose konfiskuar ne kuadër te fushëveprimit te tij gjate periudhës raportuese (1 janar-dhjetor 2024) nder te tjera:

Gjate periudhës raportuese ka zhvilluar **16 (gjashtëmbëdhjetë)** procedura te Ankandeve Publike dhe janë realizuar te ardhura ne vlerë prej **52.051.10 €**

ka pranuar Vendime për kthim te pasurisë dhe ka zhvilluar **30 procedura te Kthimeve** të pasurisë ;

Janë dhëne në Shfrytëzim Vetura dhe sende tjera siç janë përcaktuar me Vendim te AAPSK-se dhe Gjykatës, ku janë zhvilluar **23 procedura te dhënies ne Shfrytëzim**. Pasurit e lartcekur janë dorëzuar për shfrytëzim tek institucionet përkatëse.

Janë zhvilluar 16 (gjashtëmbëdhjetë) Ankande Publike dhe janë realizuar te ardhura ne vlerë prej 52.051.10 €

- Paraqitja tabelore e ankandeve gjatë vitit 2024:

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	total
Ankande	0	1	2	1	1	2	1	1	0	3	1	3	16

Janë pranuar Vendime për kthim të pasurisë dhe janë zhvilluar 30 procedura të Kthimeve të pasurisë (si ne tabelë);

- Paraqitja tabelore e procedurave te kthimit gjatë vitit 2024:

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	total
Kthim	0	3	1	2	3	2	4	5	0	3	3	4	30

- Paraqitja tabelore te dhënies ne shfrytëzim gjatë vitit 2024:

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	total
Shfrytëzim	4	3	1	3	0	2	1	2	4	3	0	0	23

Trajnimet dhe punëtoritë

- Zyrtaret e Agjencise, kanë marrë pjesë në tetëmbëdhjetë (18) punëtori dhe trajnime të ndryshme me gjithsejt, katërdhjetë e pesë (45) pjesëmarrës

PËRMBUSHJA E OBJEKTIVAVE


Objektivat	Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet (Autputet)	Rezultatet (autputet) e planifikuara	Shënim shpjegues
1.Administrimin i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	1.Numri i vendimeve të ekzekutuar 2.Vlerësimi, ruajtja e vlerës së pasurive në administrim të AAPSK-se 3.Realizimi i ankandeve, të hyrat e realizuara nga shitjet dhe dhënia në shfrytëzim. 4 Dhenia në shfrytëzim institucioneve			1. Pranimi i pasurive në administrim 2. Vlerësimi i pasurive në administrim 3.Mirembajtja e pasurive në administrim 4 regjistrimi pasurive në administrim në bazën e të dhënave	1. PO 2. PO 3 PO 4. Pjesëri sht	Jane ekzekutuar 2023 Vendime të Gjykatave (96 sek dhe 107 konf.) vlera; 5.868,665.75euro. Janë hartuar 308 raporte të vlerësimit të psk Janë zhvilluar vizita të rregullta të pasurive të paluejtëshme dhe janë mirëmbajtur në baza ditore pasuritë e luajtshme Ne mungese të data bazës, të gjitha pasuritë janë regjistruar në tabela në Excel të cilat

	pasuritë konfiskuara	e		5 numri i ankandever te realizuar dhe ekzekutimi i vendimeve te tjera te Gjykates	5.PO	përditësohen ne baza ditore Jane zhvilluar 16 ankande te shitjes me nje realizim prej; 52,051.10 euro Janë dhene ne shfrytëzim 56 mjete te transportit, 2 banesa, i Autoambulance dhe paisje te ndryshme elektronike
2.Avancimi i Burimeve Njerëzore dhe Infrastrukturës në Depo	1.Pozitat e rekrutuara dhe numri i trajnimeve 2.perfundimi i sallës se ankandeve			1.rekrutimi i pozitave te lira dhe organizimi i pjesëmarrjes se stafit ne trajtime dhe përmirësimi n e kushteve te punes 2.Inventarizi mi i sallës se ankandeve ne depon e AAPSK-se 3.korrespode ncat me gjykatat e kosoves dhe hartimi i dokumentev	1.PO 2.PO 3.PO	Janë shpallur katër (4) procedura te rekrutimit dhe janë plotësuar dy pozita; Zyrtare e AAPSK- se kane marr pjese ne 18 punetori dhe trajtime te ndryshme me gjithesej 45 pjesemarres Ëshë funksionalizuar salla e ankandeve Në secilin rast te ekzekutimit te vendimeve te Gjykatave zhvillohet nje koordinim me

				e per funksionim te institucionit.		gjyqtarin e rastit, proku rastit dhe hetuesit e rastit
				4. krijimi i platformes per zhvillimin e ankandeve online	4.JO	Eshtë në proces të realizimit nga GIZ.
				5 Rishikimi i planit strategjik Te AAPSK-se	5.JO	Do bëhet pas ristrukturimit të Agjencisë.
				6.Rishikimi i PSV per pranimin, vlerësimi n, ruajtjen, asgjësimin dhe shitjen e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara	6.JO	Do bëhet pas ristrukturimit të Agjencisë.
				7 Menagjimi i bugjetit te AAPSK-se	7.PO	Buxheti në raport me alokimet është shpenzuar në masën 89.5%
3.Bashkëpunimi ndërinstitutional me Institucionet vendore dhe nderkombetare lidhur me administrimin e pasurisë se sekuestruar dhe te konfiskuara.	1.takime me institucionet e zbatimit te ligjit dhe institucionet tjera lidhur me pasuritë e sekuestruara			1.Aktivitetet e perbashketa ne fushën e sekuesrimit dhe te konfiskimit me akteret relevant	1.PO	Kemi realizuar takime me Gjykatat , Prokuroritë, Zyen e Koordinatorit Nacional per Luftimin e

	dhe të konfiskuara			2. Aktivitetet e përbashkëta me organet qendrore dhe lokale të RKS	2.PO	Krimin Ekonomik. Janë mbajtur takime të rregullta me abinitin e MD, MPB dhe institucione tjera vendore. Janë lidhur dy memorandume të bashkëpunimit.
	2. takime me institucionet relevante nderkombetare lidhur me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara			3. koordinim me projektet mbështetëse dhe institucionet nderkombet are	3.PO	Ka vijuar bashkëpunimi me Projektet: PECK III; SEAK III-UNDP; GIZ.
				4. vendosja e formave të bashkëpunimi dhe shkëmbimit të përvojave me institucionet relevante nderkombet are lidhur me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.	4.PO	Bashkëpunim dhe takime të rregullta me organizatën BAMIN

Me respekt,

Fadil Bunjaku

 UD. i Drejtorit të Përgjithshëm